



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Komunikim Ndërkulturor

Ngarkesa: 6 kredite, 30 orë leksione, 30 orë seminar

Viti / Semestri: Viti I, semestri I,

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në "Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh"

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të ndërtojë dhe zhvillojë kompetencën ndërkulturore të studentit, duke nxitur reflektimin dhe tolerancën ndaj kulturave të tjera në një botë të globalizuar. Të pajisë studentin me njohuri teorike dhe praktike mbi komunikimin ndërkulturor, me fokus në konceptet e kulturës, identitetit, diversitetit, akulturimit dhe transformimit kulturor. Të nxisë një qasje kritike dhe integruese të studentit ndaj realitetit kulturor bashkëkohor, duke promovuar ndërveprimin mes kulturave si kusht për bashkëjetesë, zhvillim shoqëror dhe respekt të ndërsjellë

Objektivat specifike lëndore:

1. Të identifikojnë dhe analizojnë konceptet thelbësore të kulturës dhe komunikimit ndërkulturor, duke përfshirë nocione si stereotipet, etnocentrizmi, relativizmi kulturor, identiteti kulturor dhe ndërveprimi gjuhësor e simbolik.
2. Të aftësohen në aplikimin e strategjive të përshtatshme të komunikimit në kontekste reale ndërkulturore, duke marrë parasysh kodet e sjelljes, pritshmëritë kulturore dhe mjediset profesionale ku ndodh ndërveprimi me përfaqësues të kulturës B.
3. Të zhvillojnë një qasje reflektuese dhe kritike ndaj sfidave të komunikimit ndërkulturor, duke analizuar raste konkrete nga përvoja personale, nga media, ose nga konteksti turistik dhe ndërveprimet ndërkombëtare.

Rezultatet e pritshme:

1. njohë debatet që zhvillohen lidhur me Komunikim ndërkulturor.
2. ndërgjegjësohet për rëndësinë e komunikimit ndërkulturor
3. kuptojë se vizioni etnocentrik klasik tejkalohet.
4. Kultura shqiptare përballë asaj evropiane.